



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 440/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me apelin e koalicionit NISMA – AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.440/2019 i datës 07.11.2019, i paraqitur nga koalicioni kandidati për deputet Haxhi Shala nga koalicioni NISMA–AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019,

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.11.2019, ka pranuar apelin Anr.440/2019, e paraqitur nga kandidati për deputet Haxhi Shala nga koalicioni NISMA–AKR-PD, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit me Nr.1304 SHFMU, “Idriz Ajeti”, në Shalë, Komuna e Lipjanit, në vendvotimet me Nr.1304E/01R, 1304E/02R dhe 1304E/03D, nga rezultatet e publikuara nga KQZ-ja, këtij subjekti i figurojnë vetëm 50 vota, ndërsa në këto vendvotime, ky subjekt politik ka më shumë përkrahës, miq dhe njerëz që kanë punuar në shtabin zgjedhor të këtij subjekti e të cilët i kanë raportuar se ka më tepër vota për këtë subjekt politik, duke shtuar se në këto vendvotime dyshohet se vota nuk është lexuar drejtë, është devijuar vullneti qytetar dhe përveq kandidatit është dëmtuar edhe vetë subjekti politik. Më tej paraqitës i ankesës me pretendimet e njëjta ka kërkuar edhe rinumërimin e 62 vendvotimeve në Komunën e Suharekës, dhe atë vendvotimet si në vijim: 2401A/03R, 2401A/04R, 2401A/05R, 2401A/06R, 2401A/08R, 2401A/09R, 2401A/11R, 2401A/12D, 2402A/01R, 2402A/02R, 2402A/03D, 2403A/02R, 2403A/03R, 2403A/05R, 2404A/01R, 2404A/02D, 2405A/01R, 2405A/02R, 2405A/03R, 2405A/04D, 2406A/01R, 2407A/01R, 2407A/02R, 2408A/01R, 2408A/02R, 2408A/03D, 2409A/02R, 2410A/01R, 2411A/01R, 2411A/02D, 2412A/02R, 2412A/03D, 2413A/01R, 2413A/02R, 2413A/03D, 2414A/01R, 2414A/02R, 2415A/01R, 2415A/02D, 2416A/01D, 2417A/01R, 2417A/02R, 2417A/03R, 2417A/04R, 2418A/01R, 2418A/02R, 2418A/03R, 2418A/04D, 2419A/01R, 2419A/02D, 2420A/01R, 2420A/02D, 2421A/01R, 2422A/01R, 2422A/02R, 2426A/02R, 2426A/03R, 2426A/04D,

2427A/01D, 2429A/01D, 2431A/01D, 2433A/01D. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që përmes KQZ-së, të rinumëroj këto kuti votimi në mënyrë që të kemi rezultate të drejta dhe të sakta.

Në përgjigje në ankesë, KQZ-ja, lidhur me pretendimet e apeluesit për rinumërim të vendvotimeve në Komunën e Suharekës dhe atë të Lipjanit, të cekura si në ankesë, ka theksuar se asnjë Formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti do t'i nënshtrohet Auditimit në QNR.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave tjera të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se paraqitësi në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij, prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me prova konkrete, pasi që paraqitësi i apelit vetëm dyshon se ka shkelje dhe pritjet e tij për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkuptojnë se ka mospërputhje të rezultatit, andaj si i tillë apeli është jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 të LZP-së.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.440/2019 më datë 09.11.2019

Kryesues i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.